

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“REALIZIMI DHE PRODHIMI I MATERIALEVE PROMOCIONALE PËR PROMOVIMIN E
MARKËS, SHËRBIMEVE POSTARE - FINANCIARE DHE PRODUKTE FILATELIKE”**

Fondi limit në total: 5,000,000 (pesë milion) lekë, pa TVSH.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22900000-9

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete
të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Specifikimet teknike, fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukture e posaçme e ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 60(gjashtëdhjetë) ditë kalendarike.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

“ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 39% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1. 1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Blerësi dhe Shitësi.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të

ngjashme të jenë një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontratë të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontratë të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 19 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi për stafin e punonjësve si dhe listë pagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Qershor – Gusht 2025, nga të cilët:

-1 punonjës i diplomuar për disegner grafik

Për punonjësit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës/ kontratë bashkëpunimi, dhe diploma/certifikime nga kompani/institucione të certifikuara si edhe të figurojnë në listë pagesat e kompanisë.

*(Për Kontratën e Bashkëpunimit sqarojmë se duhet të jenë të vlefshme deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi dhe jo domosdoshmërisht t'i kenë pjesë të stafit të Pasqyruar në listë pagesa)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën:

- **Certifikatën ISO 9001 - 2015 ose ekuivalente.**

(Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: (Lidhur me certifikatën e sipërcituar sqarojmë se vendosja e këtij kriteri gjën mbështetje dhe u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikatë duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar

kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

(Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001- 2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.)

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë dhe provojë se zotëron në pronësi ose me kontratë qiraje të noterizuar, e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës të paktën:

- Dy makineri printimi/shtypi industrial.

Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 5 m gjerësi pa ndërprerje.

Kjo pikë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes të faturave tatimore të blerjes sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është blerë, deklaratën doganore.

Në rastin e marrjes me qira, të paraqitet i gjithë dokumentacioni i mësipërm, shoqëruar me kontratën noteriale të qiramarrjes e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës, ku pajisja duhet të provohet se është në bilancin e kompanisë qiradhënëse.

(Per makineritë e printimit OE duhet të paraqesë dhe broshurat me informacion të detajuar nga prodhuesi.)

Argumentimi:(Kriteret 2.3.2 dhe 2.3.4 do të shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për të përmbushur kontratën, për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, makineritë dhe pajisje të nevojshme dhe të mjaftueshme, për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.)

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë përmes së cilës merr përsipër të kryej dizajnin sipas specifikimeve teknike në shtojcën 6.

Argumentimi :Deklarata i shërben Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen se operatori fitues do të kryej dizajnin për zërat e përcaktuar.

2.3.6. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat fizike për artikujt sipas shtojcës së specifikimeve teknike, pa logo të postës dhe të personalizuar.

(Shënim) Mostrat fizike do të vlerësohen të rregullta me ose pa logo të personalizuar ose të papersonalizuara.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Dorëzimi i mostrave është shumë i rëndësishëm për procesin e vlerësimit teknik dhe verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike.

Theksojmë se, kriteret e veçanta për kualifikim janë parashikuar në përputhje me specifikimet teknike të përgatitura nga grupi i ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe të mbështetura të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2021 “Për Prokurimin Publike”, dhe nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike”

Njësia e Prokurimit: